

AKT THEMELIMI

I

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“ÇOBO HOLDINGS 2010” Shpk

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 16 /09/2022, krijohet shoqëria “**ÇOBO HOLDINGS 2010**” Shpk nga ortaku i vetëm Z.Ferdinand Çobo, shtetas shqiptar me përgjegjësi të plotë juridike për të vepruar.

Kjo shoqëri themelohet në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjin Nr 9723 date 03.05.2007 “Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” me ndryshimet e mëvonshme

Themeluesi i kompanisë:

- **FERDINAND ÇOBO**, lindur në Vlorë, më 20/05/1963, me Nr. ID : **G30520283J** Banues ne Vlorë.

Neni 2:

Objekti

Objekti i shoqërisë do të jetë: Aktivitet ne fushen e ndertimit, sherbimeve dhe tregtise. Ne fushen e projektimit e ndertimit te veprave te ndryshme prej murature tulle,guri, betoni, punime dheu, ndertime civile,industriale, bujqesore dhe turistike. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore.Ndertim rruges, punime te mirembajtjes ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore. Montimi dhe instalimi i impianteve termike te ventilimit dhe kondicionimit te ajrit. Ndertim ura e vepra arti, ndertim tunele rrugore-hekurudhore.Ndertim ujesjelleskanalizime, kanale e impiante vaditje-kullimi-sillose, kulla, kulla uji etj.Germime, drenazhime punime ne toka bujqesore etj.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kompanisë do të jetë në një periudhë pa afat.

Neni 4:

Selia

Selia e kompanisë është në adresën: Skelë, Lagjia “Pavarësia”, Sheshi “Pavarësia”, Pallati “Çobo” kati 1 , Nr.16, 9401, Vlorë.

Me të drejtë për të ndryshuar qendrën e saj dhe për të hapur degë dhe filiale të tjera në Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Asambleja e përgjithshme e shoqërisë mund të krijojë, modifikojë apo të anultojë seli sekondare agjensi dhe përfaqësi kudo që e quan të nevojshme edhe jashtë shtetit.

Neni 5

Kapitali themeltar

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin themeltar të shoqërisë është në 1 kuotë, në përputhje me kontributin e tij si më poshtë:

Kapital financiar: **100,000**

1. Ortak, Themelues: **FERDINAND ÇOBO** zotërues i 1 (një) kuote, i cili zotërohet 100% nga ortaku i shoqërisë .

Neni 6:

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administrator i shoqërisë caktohet : - **FERDINAND ÇOBO**, lindur në Vlorë, më 20/05/1963, me Nr. ID : **G30520283J** Banues në Vlorë

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e përgjithshme.

ORTAKU
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ÇOBO HOLDINGS 2010”

Emër mbijetë (nenshkrimi)

Ferdinand Çobo
